



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Rregullores 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje te qëndrueshme, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026 të miratojë këtë

PROPOZIM

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME 2026-2028

Neni 1

MIRATOHET , Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2026-2028.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2026-2028.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra Lokale e Komunës për Komunitete.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Arsyetim

Baza ligjore për miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Rregullores 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje te qëndrueshme, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 016/01-17797

Lipjan, Më 20.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





**PLANI KOMUNAL I
VEPRIMIT PËR TË
ZHVENDOSURIT DHE
ZGJIDHJE TË
QËNDRUESHME
2026-2028**

KOMUNA E LIPJANIT

**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE
DHE KTHIM**

2026

PARATHËNJE

Plani Komunal për Veprim (PKV), konfirmon përkushtimin dhe vullnetin politik të Komunës së Lipjanit për ofrimin e mjedisit të sigurt dhe mundësinë e kthimit e të gjithë qytetarëve, të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, pa dallim etnie, fesë dhe përkatësisë politike. Konsideratë e veçantë do t'i kushtohet integritet socio-ekonomik gjatë hartimit të planit të veprimit i cili do ti përgjigjet aftësive aktuale të familjeve të kthyer në mënyrë që të sigurohet zgjidhja e qëndrueshme e të kthyerve.

ARSYESHMËRIA E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT (PKV)

Ky plan veprimi ka për qëllim ta ndihmojë Komunën në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të ri-integrimit në bazë të Rregullores nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, në bazë të kërkesës për asistencë për kthim vullnetarë nga personat e zhvendosur dhe vlerësimit të nevojave specifike sipas sistemit të menaxhimit të të dhënave.

1. HYRJE

Institucionet e Kosovës kanë një detyrim kushtetues për të krijuar kushtet dhe të sigurojnë mjetet e nevojshme për personat e zhvendosur që të kthehen në shtëpitë e tyre në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet. I tërë ky proces kërkon bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse që mund të kontribuojnë në suksesin e procesit të kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve.

PKV përcakton aktivitetet për kthim të qëndrueshëm dhe zhvillimin e të gjitha komuniteteve, i cili ka ndikim në të gjitha aspektet e jetës (ekonomike, shoqërore dhe institucionale) në të gjitha nivelet.

Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i PKV-së, Komuna zotohet që ky plan do të jetë në përputhshmëri të plotë me strategjitë dhe planet tjera zhvillimore komunale, si dhe do të planifikoj dhe ndaj fondet në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të vet, dhe do të kërkoj fonde në bashkërendim me akterët tjerë për realizimin e këtij plani.

2. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e Kosovës riafirmon të drejtën për kthim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përvijon garanci gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve. Plani komunal i veprimit bazohet në nenin 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹ dhe është në pajtim me Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë²; Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, “që përcakton bazën

¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 156; <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531>

ligjore për mbështetjen e familjeve në nevojë për banim social dhe të përballeshëm. Neni 4, përfitues potencial janë familjet që nuk posedojnë banesë, që kanë mbetur pa strehim si pasojë e dëmtimeve nga konflikti”, me rregullore 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjestarve të tyre 2023-2027 ,Plani Zhvillimor Komunal , Programi Komunal 3 vjeçar për banim

3. OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI

Objektivat e identifikuar në këtë dokument, janë zhvilluar në aktivitete konkrete në PKV, në mënyrë që t’i mbulojnë të gjitha fushat e veprimit të Komunës së Lipjanit me qëllim që të adresohen nevojat e të zhvendosurve kosovarë. Komuna e Lipjanit synon kthimin e qëndrueshëm dhe stabilizimin e komuniteteve, prandaj objektivat e mëposhtme në mënyrë konkrete kontribuojnë në realizimin e këtij synimi:

1. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të zhvendosur në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni;

- 1.1 Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim;
- 1.2 Menaxhimi i të dhënave në bashkëpunim me MKK-në;
- 1.3. Ofrimi i strehimit dhe asistencës socio-ekonomike për familjet e zhvendosura sipas kritereve dhe cenueshmërisë;
- 1.4. Ofrimi i strehimit dhe subvencionimit të qirasë do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-164 për programet e veçanta të banimit, duke prioritetizuar familjet pa strehim, familjet e cenueshme dhe kategoritë e përcaktuara me ligj.
- 1.5. Sigurimi i masave të përkohshme të strehimit, përfshirë qiranë, të përdoren si mekanizëm tranzitor drejt zgjidhjeve të qëndrueshme
- 1.6. Forcimi i mekanizmave ekzistues të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve;
- 1.7 Ofrimi i mundësive për ndarjen e tokës për rastet e veçanta sipas Ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
- 1.8 Dialog ndëretnik në mes të personave të zhvendosur dhe komunitetit pranues;

2. Integrimi socio-ekonomik;

- 2.1 Mbështetja për integrim ekonomik në bazë të vlerësimit të nevojave për jetesë dhe mirëqenie socio-ekonomike në bazë të kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes për asistencë, të përcaktuara me rregullore;
- 2.2 Krijimi dhe mbështetja e projekteve zhvillimore ekonomike të bazuara në komunitete;

2.3 Monitorimi dhe raportimi

3. Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kthim dhe ri-integrim;

4. PASQYRA KOMUNALE

4.1 INFORMATA TË PËRGJITHSHME DHE TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Komuna e Lipjanit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe sipërfaqe prej rreth 338,54 km². Kjo komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të qendrave më të mëdha të rajonit siç janë Prishtina dhe Mitrovica.

Para konfliktit të vitit 1999, në këtë komunë kanë jetuar një më i madh i komuniteteve jo shumicë se sa statistikave aktuale (sidomos nga komuniteti serb dhe rom), ku një pjesë e tyre ende mbeten të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi. Po ashtu, si rezultat i ngjarjeve të Marsit të vitit 2004, një pjesë e populluar nga komuniteti Serb në pjesën urbane të qytetit u zhvendosën në fshatrat fqinje.



ka një

numër

Sa i përket komuniteteve Rom, Egjiptian e Ashkali tradicionalisht kanë jetuar në gjendje të vështirë socio-ekonomike në Komunën e Lipjanit. Ata jetojnë në disa lokalitete por shumica kryesisht janë të orientuar në disa vende: Gadime, Magurë, Medvec, Lipjan qytet, Hallaq, Dobrajë etj. Pas konfliktit, pjesëtarët e këtyre komuniteteve kryesisht janë kthyer në mënyrë spontane.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të kryer më 2024, popullsia totale është 55044³.

Popullsia në Komunën e Lipjanit	Gjithsej	Etniteti									
		Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Preferoj të mos përgjigjen	Te tjerë
Total	55,044	51861	569	153	39	318	1891	11	11	11	180

Tabela 1: Popullsia në komunën e Lipjanit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2024.

4.2 EDUKIMI

Në Komunën e Lipjanit gjenden 24 shkolla fillore me 11.342 nxënës dhe 852 të punuar; 3 shkolla të mesme me 2,639 nxënës dhe 272 të punuar 1 çerdhe amë dhe 4 paralele të ndara fizike dhe në kopshte me 350 fëmijë me 27 të punuar. Gjithashtu, është edhe një shkollë fillore me 3 paralele të ndara me gjithsej 65 nxënës, si dhe 1 institucion parashkollor me 20 nxënës që kryejnë aktivitetet e tyre sipas planit dhe programit të Serbisë.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Regjistrimi i popullsisë më 2024

4.3 EKONOMIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Situata ekonomike në komunë është një reflektim i qartë i një realiteti në mbarë Kosovën me një shkallë të lartë të papunësisë dhe mungesë të përgjithshme të zhvillimit ekonomik. Në bazë të statistikave të Qendrës për Punë Sociale në komunën e Lipjanit shfrytëzues të ndihmave sociale janë gjithsej 890 familje me 3721 individ⁴.

Ekonomia e Komunës së Lipjanit është e bazuar kryesisht në bujqësi dhe biznese të vogla tregtare. Janë rreth 3448, nga ta: 22 Ortakri (OP), 1896 SHPK, Biznese Individuale 1555, Degë të Shoqeris se saj 10 dhe 5 Shoqëri aksionare. Në Komunën e Lipjanit, numri i të punësuarve në sektorin publik është rreth 1,505. Minierat në Magurë dhe Babush nuk funksionojnë, kryesisht për shkak të teknologjisë së dëmtuar dhe të vjetruar. Nuk ka të dhëna mbi numrin e të papunësuarve, edhe pse besohet të jetë i lartë si në mbar Kosovën.

4.4 SHËNDETËSIA

Në Komunën e Lipjanit kryhen shërbime primare mjekësore. Këto shërbime qytetarët e Komunës së Lipjanit i kryejnë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe në katër (4) Qendra të mjekësisë familjare dhe shtatë (7) Ambulancave të Mjekësisë Familjare nëpër fshatra. Të gjitha komunitetet kanë qasje në shërbimet dhe qendrat shëndetësore. Megjithatë, për shërbimet primare, komuniteti serb shfrytëzon edhe shërbimet e ofruara nga institucionet Serbe, të vendosura në një kontejner në pronën e Kishës Ortodokse Serbe në Lipjan dhe në Grackë të Vjetër. Sektori i Shëndetësisë ka 238 të punësuar, 157 femra dhe 81 meshkuj, duke përfshirë edhe mjekët, infermierët dhe personelin ndihmës⁵.

5. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR PERSONAT E ZHVENDOSUR

Komuna e Lipjanit ende vazhdon të ketë persona të zhvendosur përbrenda Kosovës dhe jashtë saj (Serbi dhe Mal të Zi) si pasojë e konfliktit të vitit 1999. Statistikat e fundit të nxjerra nga UNHCR, del se janë rreth 34 familje me 113 individ⁶ që kanë shprehur dëshirën për kthim në komunën e Lipjanit, që nga viti 2010. Prej tyre: Serb 28 familje me 91 individ, Rom 3 familje me 13 individ; Ashkali 1 familje me 6 anëtar, Malazez 1 familje me 2 anëtar, dhe 1 i komunitetit boshnjak.

Që nga viti 2001 deri me tash janë regjistruar si të kthyer 545 familje me 2914⁷ individ në komunën e Lipjanit

⁴ Të dhënat nga Qendra për Punë Sociale

⁵ Profili i Komunës së Lipjanit OSBE;

⁶ Shënimet e prezantuar/ofruara nga UNHCR

⁷ Shënimet e prezantuar/ofruara nga UNHCR




Tabela 2: Numri i familjeve/individëve të kthyerë gjatë periudhës 2010/2015.

6. NEVOJAT DHE SFIDAT E IDENTIFIKUARA

Sfidat me të cilat përballen të kthyerit dhe janë të përgjithshme, për të gjitha komunitetet duke përfshirë edhe komunitetin shumicë, si në sferën e punësimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, çështjet e ndihmës sociale, etj.

Megjithatë, ka edhe nevoja që janë të veçanta për PZH-të dhe të kthyerit, si në vijim: nevoja e të dhënave bazë dhe planifikimi mbi përkrahjen adekuate në komunën e Lipjanit si dhe në rajon në Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoni; nevoja e të dhënave të sakta për PZH-të në Kosovë; fonde të pamjaftueshme për asistencë gjatë procesit të kthimit; vlerësimi jo adekuat i fizibilitetit të projekteve për krijimin e të ardhurave; zhvillimi i ngadalësuar ekonomik dhe i mirëqenies sociale; infrastruktura joadekuate publike në zonat e largëta rurale; përkrahje e pamjaftueshme për grupet e cënueshme të të kthyerve: të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara; nevoja për ndarje të tokës; lirimi i pronave të uzurpuara; fuqizimi i marrëdhënieve tregtare mes komuniteteve dhe bizneseve, pra kushtet të cilat mundësojnë një kthim të qëndrueshëm.

7. ZGJIDHJET E MUNDSHME

Për realizimin e suksesshëm të procesit të kthimit nevojitet një menaxhim i të dhënave konkrete të të zhvendosurve si dhe planifikimi për mbështetje adekuate në planifikimin e nevojave financiare të aktiviteteve të kthimit (mundësia e përfshirjes direkt të Komunës me projekte të vogla të cilat mund t'i bashkë-financoj me MKK-në dhe donatorë të mundshëm.

Konkretisht komuna do të lehtësoj procedurat dhe ofroj mundësitë për kyçe në shërbime publike, qasje në dokumente personale, arsim, shëndetësi etj.); mbështetja e nismave për bashkëveprim ndëretnik; krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik dhe punësim të barabartë për të gjithë qytetarët e saj; rritja e fondeve për grupet e cënueshme: forcimi i koordinimit në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me zbatimin e projekteve për të zhvendosurit dhe të kthyerit në fushën e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, bujqësisë, në prona, punësimit dhe mirëqenies, dhe sipërmarrjeve të reja.

8. INTEGRIMI SOCIO-EKONOMIK – KUSHTET JETËSORE

Territorin e Komunës së Lipjanit e karakterizojnë pasuritë e begatshme tokësore dhe nëntokësore, pozita mjaft e volitshme gjeografike dhe fuqia e re punëtore, të cilat kanë qenë dhe janë bazë e fortë për një zhvillim të suksesshëm ekonomik. Segmentet ekonomikë më të zhvilluara në komunën e Lipjanit janë bujqësia, blegtoria, industria e përpunuar, hoteleria dhe turizmi.

Mbështetja për integrimin ekonomik do të sigurohet në bazë të vlerësimit të nevojave të kategorive të të kthyerve bazuar në Rregulloren - nr. 01 /2018 për Kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme e cila i përgjigjet nevojave dhe aftësive aktuale të familjeve të kthyerë dhe adresimin e tyre përmes programeve të integritit socio-ekonomik. Mbështetja socio-ekonomike duhet të përqendrohet në krijimin dhe fuqizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme të bazuara në komunitet si dhe rrjetëzimin e tyre me tregun aktual biznesor.

Për më tepër segmentet ekonomike më të zhvilluara në komunë do të jenë fokus në aftësimin profesional të të kthyerve, më qëllim të përgatitjes për tregun e punës.

9. AKTERËT

Në nivel lokal bashkërendimi i aktiviteteve do të udhëhiqet nga Kryetari, ZKKK-ja, Komisioni Komunal për Kthim (KKK) dhe do të përfshijë një bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse siç janë: Arsimi, Shëndetësia, Puna dhe Mirëqenia Sociale, Shërbimet publike, Planifikimi dhe Urbanizmi, Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës dhe departamentet tjera relevante të cilat janë të përfaqësuara në Komisionin Komunal për Kthim. Në nivel qendror, komuna do të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim si institucion përgjegjës për procesin e kthimit dhe të drejtave të komuniteteve, Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë zyrës së Kryeministrit si dhe ministritë tjera relevante.

Komuna gjithashtu do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve, kthimit, dhe ri-integrimit, si dhe me donatorët e mundshëm.

10. MONITORIMI DHE EVALUIMI

Komuna do të përcjell për së afërmi procesin e implementimit të PKV-se në mënyrë efikase përmes vlerësimeve periodike.

ZKKK-ja mbikëqyrë dhe raporton për progresin e arritur në fushën e të drejtave të komuniteteve, qasjes së tyre të barabartë në shërbimet komunale, kthim dhe ri-integrimit, sipas Rregullores 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjen e qëndrueshme .

ZKKK-ja duhet të raportojë në baza të rregullta vjetore për çështjet e kthimit dhe ri-integrimit të personave të zhvendosur tek MKK-ja.

ZKKK-ja do të shërbej si Sekretariat për zbatimin e këtij Plani.

Aktiviteti	Arritshmëria	Autoritetet përgjegjëse	Korniza kohore	Kushtueshmëria dhe burimi i fondeve	Dokumentet Referente
Objektiva 1: Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të zhvendosur në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni;					
<i>Nën objektivi 1.1: Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim</i>					
1.1.1 Vlerësimi dhe rekomandimi i aplikacioneve për asistencë të personave të interesuar për kthim	35 familje; Serb 28, Rom 1, Ashkali 3, Malazez 1, Boshnjak 1 Kroat 1	MKK/ZKKK-ja dhe KKK-ja	2026-2028	MKK, Komuna/ZKKK dhe si vëzhgues; Shoqëria Civile dhe UNHCR	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
1.1.2 Ndihma në rregullimin e dokumenteve personale dhe të pronës për të zhvendosurit dhe komunitetet;	Lehtësimi i qasjes në dokumente personale dhe pronësore	ZKKK/Drejtorati i Administratës/Agjencioni për Regjistrim Civil/Drejtorati për çështje pronësore dhe kadastrës/MKK	2026-2028	Agjensioni për regjistrimin e civilëve/departamenti i pronave dhe kadastrit, MKK dhe donatorët potencial.	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
Nën objektivi 1.2: Menaxhimi i të dhënave në bashkëpunim me MKK-në;					
1.2 Menaxhimi i bazës së të dhënave për të zhvendosurit	Azhurnimi me kohë i të dhënave që do të shërbejë si mjet për monitorim dhe vlerësim të rasteve.	MKK/ZKKK	2026-2028	OKKK në bashkëpunim me MKK-në	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018

<i>Nën objektivi 1.3: Ofrimi i strehimit dhe asistencës socio-ekonomike për familjet e zhvendosura;</i>					
1.3.1 Përkrahja në strehim dhe banim, ndihmat në ushqim, dhe artikujt jo ushqimor, mobile dhe integrimin socio ekonomik	6 familjeve që i plotësojnë kriteret	ZKKK/MKK	2026-2028	Shuma e mjeteve; 300.000€ MKK/EU dhe donatorët potencial MKK, Komuna dhe donatorët potencial	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
1.3.2 Identifikimi i projekteve për koordinim me donator vendor dhe ndërkombëtarë	Donator potencial te identifikuar Projekte te zhvilluara dhe realizuara	Komuna, MKK dhe donatorët Drejtoratet relevante	2026-2028	Shuma e mjeteve; 25.000 € Burimi i fondeve; MKK/dhe donatorët potencial 25.000€ MKK Komuna dhe donatorët potencial	Rregullores nr.01/2018 per kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018 Plani komunal per Banim PZHK
<i>Nën objektivi 1.4: Forcimi i mekanizmave ekzistues të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve;</i>					
1.4.1 Asistenca në informata për PZH	Të gjithë PZH janë informuar lidhur me të drejtat, procedurat, kriteret dhe obligimet e kthimit dhe ri-integrimit	MKK/ZKKK	2026-2028	MKK, Komuna/OKKK dhe zyra për informim publik	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018

1.4.3 Hartimi i planit operativ për informim për kthim dhe publikime	Plani operativ për informim dhe publikim i finalizuar	ZKKK/MKK	2026-2028	MKK, Komuna/ZKKK	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së 02/2018
1.4.4 Organizimi i vizitave shko-dhe-informo dhe shko-dhe-shiko	vizita te kryera	ZKKK/MKK	2026-2028	Shuma e mjeteve; 2.000 € Burimi i fondeve; Komuna 1.000€ Donatorët potencial 1.000€	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
Nën objektivi 1.5: Ofrimi i mundësive për ndarjen e tokës për rastet e veçanta sipas Ligjit në fuqi për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;					
1.5.1 Identifikimi i potencialit komunal për ndarje të tokës	Parcela të identifikuar	Drejtorati Komunal i urbanizimit/gjeode zisë dhe kadastrës dhe pronës	2026-2028	Komuna/Kuvendi Komunal	Ligji nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; PZHK Plani Komunal per banim
1.5.2 Identifikimi i të kthyerve pa pronë të cilët jetonin në pronat shoqërore ose në vendbanime joformale para zhvendosjes	3 rasteve të identifikuar # i vendbanimeve formale të identifikuar # i përfituesve	ZKKK/ Drejtorati Komunal i urbanizimit/gjeode zisë dhe kadastrës dhe pronës	2026-2028	Komuna/Kuvendi Komunal	Ligji nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Rregullores nr.01/2018 per kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018 PZHK Plani komunal per banim
1.5.3 Ndarja e tokës për rastet sipas prioritetit dhe cenueshmëris	Aktualisht ekziston nevoja për ndarjen e pronës për 3 familje	Kuvendi Komunal/ Kryetari i komunës/ZKKK DPUMM	2026-2028	Komuna/Kuvendi Komunal	Ligji nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Rregullores nr.01/2018 kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme;

						Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK
1.5.4 personat e zhvendosur te liru nga taksat komunale	shfrytëzuesi	Kuvendi Komunal/Kryetari i Komunes/ZKKK	2026-2028	Komuna/Kuvendi Komunal		Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Rregullores nr.01/2018 kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
Nën objektivi 1.6: Dialog ndëretnik në mes të personave të zhvendosur dhe komunitetit prunues;						
1.6.1 Përgatitja e vizitave shko-dhe-shiko	Ka nevojë	Kryetari/ZKKK/ MKK/ Policia e Kosovës/Përfaqësuesit e komuniteteve/OJ Q-të lokale dhe ndërkombëtare	2026-2028	Shuma e mjeteve; 1.000 € Burimi i fondeve; Komuna 200€ Donatorët potencial 800€ MKK,Komuna dhe donatorët potencial		Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
1.6.2 Fuqizimi i bashkëjetesës paqësore	Realizimi i projekteve Realizimi i projekteve fushat Informuese	Kryetari/ZKKK/ MKK/ Përfaqësuesit e komuniteteve/OJ Q-të lokale	2026-2028	Shuma e mjeteve; 50.000 € Burimi i fondeve; MKK 20.000€ Donatorët potencial 30.000€ MKK,Komuna dhe donatorët potencial		Rregullores nr.01/2018 ; për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
1.6.3 Dialogu ndërmjet administrator për zgjedhjen e problemeve ne kthimin e	Projekt i përbashkët Projekt i realizuar Fusha informuese	Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Graçanicës/ZKKK K e Lipjani dhe Graçanicë -MKK	2026-2028	Komuna/KZZZ/MKK		Rregullores nr.01/2018 ; per kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së

personave të zhvendosur ne Sllovi		Përfaqësuesi i Komunitetit				
Objektiva 2: Integrimi socio-ekonomik						
<i>Nën objektivi 2.1 Mbështetja për integrim ekonomik në bazë të vlerësimit të nevojave për jetesë dhe mirëqenie socio-ekonomike në bazë të kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes për asistencë, te përcaktuara me rregullore;</i>						
2.1.1 Vlerësimi dhe profilizimi i aftësive të PZH-ve dhe të kthyerve	6 i personave të identifikuar 6 i personave të ndarë sipas profileve	ZKKK/Drejtoritë përkatëse (Punës dhe Mirëqenies sociale, etj)	2026-2028	Komuna, donatorët potencial, lidhur me grantet e të hyrave të pasurisë së paluajtshme	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e përhershme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK	
2.1.2 Referimi i të kthyerve në Zyrën për punësim	2 rasteve të referuara	ZKKK/Zyra për Punësim	2026-2028	Komuna, ZKKK dhe zyra për punësim	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e përhershme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK Strategjia për zhvillim Ekonomik Lokal	
2.1.3 Ofrimi për aftësim profesional	2 rasteve të referuara i përfituesve	ZKKK/Qendra për Aftësim Profesional/OJQ lokale dhe	2026-2028	Qendra e formimit profesional dhe donatorët potencial	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e përhershme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018	

			ndërkombëtare				
2.1.4 Asistenca për integrimin socio ekonomik	3 familjeve që i plotësojnë kriteret	ZKKK/MKK	2026-2028	Fondet e nevojshme: 300.000 Euro Burimi i fondeve: MKK/EU, Donatore potencial, Komuna 300.000 Euro	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet të qëndrueshme		
Nën objektivi 2.2 Krijimi dhe mbështetja e projekteve zhvillimore ekonomike të bazuara në komunitete;							
2.2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për projektet të bazuara në komunitet	# i projekteve të identifikuara	ZKKK/Drejtoria për zhvillim ekonomik/Drejtoria e shërbimeve publike	2026-2028	Shuma e mjeteve; 2.340,676 € Burimi i fondeve; Komuna 506,940€ Qeveria e Kosovës 1,833,736 €	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme ; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK Strategjia për Zhvillim Ekonomik lokal		
2.2.2 Përpilimi i koncept propozimeve për projektet të bazuara në komunitet	# i koncept projekteve të përpiluara	ZKKK/Drejtoritë përkatëse/MKK dhe donatorët potencial	2026-2028	Komuna, ZKKK, përfaqësuesi të komuniteteve	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK		

2.2.3 Planifikimi buxhetor për implementimin e projekteve të bazuara në komunitet	# i projekteve të buxhetuara në kuadër të buxheteve komunale	Kryetari/Drejtorit ë për buxhet dhe Financa/Zhvillim Ekonomik/ZKKK	2026-2028	Buxheti referohet në pikën 2.2.1 Komuna	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
2.2.4 Angazhimi i komunës për sigurimin e fondeve nga donatorë potencial për projekte të pambuluara nga buxheti komunal	# shuma e fondeve të siguruara # i projekteve të realizuara	Komuna, MKK dhe donatorët	2026-2028	Komuna, MKK, donatorët potencial	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
2.2.5 Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrësi	# trajnimeve të realizuara	Qendra për trajnim profesional /vendas dhe të huaj OJQ	2026-2028	Komuna, Qendra për trajnim profesional dhe donatorët potencial	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e përhershme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 Strategjia për Zhvillim Ekonomik lokal
2.2.6 Zhvillimi i projekteve infrastrukturore në bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.	# i projekteve infrastrukturor e të realizuara	Komuna/Niveli qendror	2026-2028	Komuna, Qeveria e Kosovës	Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018 PZHK
Objektiva 3. Fuqizimi i kapaciteteve komunale përgjegjëse në procesin e kthimit dhe ri-integrimit;					

3.1 Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit komunal	Nevojat për trajnim janë identifikuar	ZKKK/Shefi i personelit në komunë/MKK	2026-2028	ZKKK shuma e mjeteve; 1,800 € Ngritjet e kapaciteteve të komisionit komunal –në mënyrë që të njihen me të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme ZKKK dhe donatorët potencial	Ligji nr. 08/L-197 për zyrtar publik Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së; 02/2018
3.2 Sigurimi i trajnimeve bazuar në nevojat e stafit	2 i trajnimeve të realizuara	Komuna/MKK/ Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)	2026-2028	Komuna/Instituti i Kosovës për Administratën Publike (IKAP)dhe donatorët potencial	Ligji nr. 08/L-197 për zyrtar publik Rregullores nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
3.3 Fuqizimi i ekipit për informim dhe publikime për kthim	# i broshurave të hartuara/publikuara; # i debateve dhe intervistave ne media lokale	Komuna, ZKKK	2026-2028	Komuna/Instituti i Kosovës për Administratën Publike (IKAP)dhe donatorët potencial	Ligji nr. 08/L-197 për zyrtar publik Rregullores nr.02/2018; për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018
3.4 Vlerësimi i nevojës për trajnime lidhur me bazën e të dhënave	1 i trajnimeve	Komuna dhe MKK	2026-2028	Komuna,MKK dhe donatorët potencial	Ligji nr. 08/L-197 për zyrtar publik<<< Rregullores nr.01/2018 ; për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme; Udhëzuesi i MKK-së;02/2018